



DNV-ja VËREN SHTIM TË FUSHATËS, SHPENZIMEVE DHE GJUHËS SË URREJTJES

FAQE 4



Gjatë javës së fundit ka pasur përkeqësim të mëtutjeshëm të gjuhës dhe diskursit të përdorur në fushatë. Numri i aktiviteteve ku është përdorur

gjuhë fyese, nxitëse apo e urrejtjes pothuajse është dyfishuar, me 48 raste të evidentuara vetëm këtë javë. Aktivitetet e organizuara nga

LV-ja prijnë për nga numri i rasteve kur është përdorur gjuha e urrejtjes. Pas saj renditen AAK-ja, PDK-ja dhe LDK-ja

**KQZ-ja FILLON
TRAJNIMIN E MË SE
15 MIJË ANËTARËVE
TË KËSHILLAVE
TË VENDVOTIMIT
NË KOSOVË DHE
NË PËRFAQËSI
DIPLOMATIKE** F.7



**VDESIN TRE
TË MITUR NGA
SHEMBJA E NJË
OBJEKTI NË
JABLLANICË
TË GJAKOVËS,
BËHEN THIRRJE
PËR HETIME** F.3



**PREMTIMET PËR RRYMËN:
GAZ, THËNGJILL, BURIME
TË RIPËRTËRISHME** F.8

SPORT



**DERBI I TAKON TREPÇËS,
KRYEQYTETASIT TRIUMFOJNË NË
PRIZREN** F.10

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Presidenti i përkohshëm sirian viziton Arabinë Saudite, sinjal potencial për Iranin

RIAD, 2 SHKURT - Presidenti i përkohshëm i Sirisë, Ahmadal-Sharaa, e ka realizuar vizitën e tij të parë jashtë shtetit në Arabinë Saudite. Ky vendim po shihet si sinjal për distancimin e Damaskut nga Irani, dikur aleat kryesor rajonal. Ahmadal-Sharaa, i cili dikur kishte lidhje me Al-Kaidën, ka arritur në Riad bashkë me ministrin e Jashtëm të qeverisë së tij, Asaad-Shaibani. Dy burrat kanë udhëtuar me aeroplan saudit. Televizioni shtetëror saudit e ka trumbetuar faktin që al-Sharaa, i njohur edhe si Abu Mohammed al-Golani, ka vendosur ta bëjë vizitën e parë jashtë shtetit në Riad. Ai është takuar me liderin de facto të Arabisë Saudite, princin Mohammed bin Salman, në pallatin al-

Yamamah në Riad.

Arabia Saudite ka qenë ndër vendet kryesore arabe që ka ndarë fonde për grupet kryengritëse që kanë tentuar të rrëzojnë nga pushteti Basharal-Assad pas nisjes së protestave më 2011, të cilat u shtypën përgjakshëm nga pushteti dhe nisën luftën civile.

Në dhjetor të vitit 2024 grupi i udhëhequr nga al-Sharaa, Hayat Tahriral-Sham [HTS], ka nisur ofensivë të shpejtë, që ka rezultuar me rrëzim të Assadit nga pushteti.

Grupi i Sharaas ka qenë dikur i lidhur me Al-Kaidën, mirëpo i ka prishur lidhjet me kalimin e kohës.

HTS është organizatë e shpallur terroriste nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian.

Irani nuk e ka rihapur ende

ambasadën në Damask, vend në të cilin ka kryer shumë operacione përmes të ashtuquajturit Bosht i Rezistencës, përfshirë Assadin në Siri, Hezbollahun në Liban dhe partnerë të tjerë.

Rusia, në anën tjetër, e ka humbur qasjen në bazat e veta ushtarake në Siri, prej largimit të Assadit nga Siria.

Vetë presidenti rus Vladimir Putin ia ka miratuar azilin atij dhe familjes së tij në Moskë.

Veprimet e Sharaas duket se mëtojnë ta sigurojnë Perëndimin për qasjen e re, me qëllim të heqjes së sanksioneve ndaj Sirisë.

Rindërtimi i shtetit pas një dekade të luftës do të kushtojë qindra miliarda dollarë, pa përmendur edhe nevojat e popullit sirian, pasi një pjesë e mirë e tyre kequshqehen.

Ministri i Jashtëm saudit, Faisal



bin Farhan, e ka vizituar Damaskun në janar dhe ka thënë se Riadi është i angazhuar në dialog për heqjen e sanksioneve ndaj Sirisë.

Arabia Saudite, për dallim prej Turqisë dhe Katarit, pati rikthyer lidhjet me Assadin më 2023, sikurse shumica e

vendeve të botës arabe.

Heqja e sanksioneve mund të ndikojë në thellim më të madh të marrëdhënieve.

Ndërkohë, Qeveria e përkohshme e Sirisë vazhdon të përballlet me sfida për shkak të pranisë së grupit ekstremist, Shteti Islamik dhe grupeve të tjera brenda territorit sirian.

Trumpi vendos tarifa, Kanadaja, Meksika dhe Kina zotohen për kundërmasa

UASHINGTON, 2 SHKURT - Presidenti amerikan Donald Trump ka vendosur tarifa prej 25-përqindësh në importet prej Kanadasë dhe Meksikës dhe 10 për qind në mallrat prej Kinës, nisur nga dita e martë. Ai ka thënë se vendimi është marrë për ta adresuar emergjencën kombëtare për shkak të fentanolit dhe mallrave të tjera ilegale që po hyjnë në Shtetet e Bashkuara, sipas Shtëpisë së Bardhë.

Importet e energjisë nga Kanadaja do të kenë vetëm 10 për qind taksë, mirëpo importet e energjisë prej Meksikës do të përballen me 25 për qind taksë, kanë thënë zyrtarët amerikanë për gazetaret.

Tarifa është taksë e brendshme e vendosur mbi mallrat kur ato hyjnë në një vend, në përpjesëtim me vlerën e importit. Ajo janë në qendër të vizionit ekonomik të Trumpit. Ai i sheh si mënyrë për ta rritur ekonominë amerikane, për t'i mbrojtur vendet e punës dhe për t'i rritur të hyrat nga taksat.



Trumpi ka shpallur emergjencë kombëtare nën Aktin Ndërkombëtar për Emergjenca Ekonomike, në mënyrë që ta arsyetojë vendimin për tarifa, dhe të ketë më shumë kompetenca për ta adresuar krizën.

Zyrtarët e Shtëpisë së Bardhë kanë thënë se askush nuk do të përjashtohet nga tarifat.

Trumpi ishte zotuar për vendosje tarifash edhe gjatë

fushatës zgjedhore.

Presidentja e Meksikës, Claudia Sheinbaum, i ka quajtur "shpifje" pretendimet se qeveria meksikane ka aleanca me organizatat kriminale. Megjithatë, ajo ka thënë se shteti i saj është i gatshëm të punojë me ShBA-në. "Problemet nuk zgjidhen duke vendosur tarifa, por duke folur", ka thënë ajo.

Ajo e ka udhëzuar ministrin e

Ekonomisë që të përgjigjet me masa tarifore dhe jotarifore. Ky vend pritet të vendosë tarifa hakmarrëse prej 25-përqindësh në mallrat amerikane.

Kryeministri i Kanadasë, Justin Trudeau, ka thënë se edhe vendi i tij do të përgjigjet. "Nuk duam të jemi në këtë pikë, nuk e kemi kërkuar këtë", ka thënë ai në një konferencë për medie. Qeveria e tij do të vendosë 25 për qind tarifa në mallrat amerikane në vlerë të 155 miliardë dollarëve.

Një pjesë e tarifave do të hyjnë në fuqi të martën, ndërsa pjesa tjetër pas 21 ditësh.

Kryeministri kanadez ka hedhur poshtë sugjerimin se kufiri i përbashkët përbën shqetësim për sigurinë, duke thënë që më pak se 1 për qind e fentanolit hyn në ShBA përmes Kanadasë.

Me qëllim të shmangies së të gjitha tarifave, Otava është zotuar për ndarje të 1.3 miliard dollarëve për masa të reja të sigurisë në kufi me ShBA-në. "Tarifat nuk janë mënyra më e

mirë si mund të punojmë së bashku dhe të ruajmë jetë", ka thënë Trudeau.

Kanadaja, Meksika dhe ShBA-ja kanë ekonomi të integruara thellësisht, me mallra në vlerë të dy miliardë dollarëve që kalojnë nëpër kufij çdo ditë. Kina ka thënë përmes një deklarate se është tejet e pakënaqur me masat dhe i kundërshton ashpër ato.

Tarifa prej 10-përqindësh do të jetë masë shtesë mbi tarifat që veçse i janë vendosur Kinës nga Trumpi në mandatin e parë, si dhe të tjerat nga ish-presidenti Joe Biden.

Kina ka thënë se do të ngrejë padi në Organizatën Botërore të Tregtisë kundër ShBA-së dhe do të ndërmarrë kundërmasa për t'i ruajtur të drejtat dhe interesat e veta.

Kryeministri i Kinës, Ding Xuexiang, ka thënë muajin e kaluar në Forumin Ekonomik Botëror, në Davos të Zvicrës, se shteti i tij është duke kërkuar zgjidhje që përbën fitore për të dyja palët, dhe që dëshiron t'i zgjerojë importet.

Ukraina t'i mbajë zgjedhjet pas armëpushimit, thotë ndihmësi i Trumpit

Uashington, 2 shkurt - Shtetet e Bashkuara dëshirojnë që Ukraina t'i mbajë zgjedhjet, potencialisht deri në fund të vitit, sidomos nëse Kievi arrin marrëveshje armëpushimi me Rusinë në muajt vijues, ka thënë zyrtari amerikan Keith

Kellogg në një intervistë për agjencinë e lajmeve "Reuters".

Kellogg, i dërguari amerikan për Ukrainën dhe Rusinë, ka thënë se zgjedhjet parlamentare dhe presidenciale të Ukrainës, të pezulluara gjatë luftës, "duhet të mbahen".

"Shumica e vendeve demokratike mbajnë zgjedhje në kohë lufte. Mendoj se është e rëndësishme të veprojnë ashtu", ka thënë Kellogg. "Është mirë për demokracinë. Ajo është e mira e demokracisë solide, kur keni më shumë se një

person në garë".

Trumpi dhe Kellogg kanë thënë se janë duke punuar në një plan për të ndërmjetësuar një marrëveshje në muajt e parë të administratës amerikane, për t'i dhënë fund luftës së Rusisë në Ukrainë, të nisur në shkurt të vitit 2022.



Vdesin tre të mitur nga shembja e një objekti në Jabllanicë të Gjakovës, bëhen thirrje për hetime

GJAKOVË, 2 SHKURT - Tre fëmijë kanë vdekur të shtunën në fshatin Jabllanicë të Gjakovës si pasojë e shembjes së një objekti të vjetër. Sipas raportit ditor të Policisë së Kosovës, objekti është shembur në rrethana të panjohura, ndërsa tre djemtë - dy 15 vjeç dhe tjetri 13 vjeç kanë qenë brenda kur janë zënë nga pllaka. Majori i Policisë së Kosovës, Milazim Lumi, ka thënë për mediet se objekti i shembur ka qenë ndërtesë e vjetër, e pabanuar, e mbetur pas luftës së vitit 1999 në Kosovë. Familjari i viktimave, Përparim Ademaj, ka thënë të dielën për mediet lokale se të rinjtë kanë dalë disa orë para incidentit për të luajtur së bashku, ndërsa familjarët e kanë zbuluar se ata kanë qenë në objektin e rrënuar nga dridhjet e telefonave, sa kanë qenë duke i kërkuar në rrethinë. Sipas tij, kamerat e shtëpive në afërsi tregojnë se objekti i pabanuar është shembur rreth orës 16:35 të shtunën, ndërsa trupat e viktimave janë gjetur pas gati gjashtë orëve. "Policia, ambulancat, zjarrfikësit kanë

ardhur shumë shpejt. I kemi gjetur pa shenja jete", ka thënë ai. Familjarët kanë bërë me dije se trupat e tre djemve do të varrosen të hënën në varrezat e fshatit Jabllanicë. Zyra e Prokurorit të Shtetit ka bërë me dije se në vendin e ngjarjes kanë dalë kryeprokurori, prokurori kujdestar dhe të gjitha njësitet e tjera përkatëse të Policisë së Kosovës, dhe që janë duke u ndërmarrë të gjitha masat për zbardhjen e rastit. Trupat e viktimave janë dërguar në Institutin e Mjekësisë Ligjore për obduksion. Presidentja e Kosovës u ka shprehur ngushëllime më të sinqerta familjarëve për incidentin që e ka quajtur tragjik. "Nuk ka fjalë që mund ta lehtësojë dhimbjen e familjeve që sot po përballen me boshllëkun e pafund që lë pas humbja e më të dashurve të tyre", ka thënë Osmani në "Facebook". Kryeministri i Kosovës ka thënë se kjo vdekje e trefishtë e ka pikëlluar mbarë popullin. "Në këtë periudhë të rëndë u shpreh



ngushëllime të sinqerta familjeve Mehmeti, Rama dhe Morina, duke u lutur që ta gjejnë forcën për të përballuar këtë dhimbje të madhe. Qeveria e Republikës së Kosovës është pranë jush në këto ditë të vështira", ka thënë Kurti në "Facebook". Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka bërë thirrje që të bëhet hetim i tërësishëm i rastit. Thirrje për hetime kanë bërë

edhe figura të tjera politike. Kryetari i Gjakovës, Ardian Gjini, ka thënë se është i tronditur nga lajmi për vdekjen e tre fëmijëve, dhe i ka ngushëlluar familjarët. "Le të bëjmë krejt çka mundemi të jemi me familjet në këto çaste të rënda!", ka thënë ai përmes në "Facebook". Kryetari i Prishtinës, Përparim Rama, u ka shprehur ngushëllime familjarëve dhe ka thënë se kryeqyteti ka

gatishmëri për t'i ofruar çdo ndihmë të mundshme komunës së Gjakovës. "Një tragjedi e tillë na kujton përgjegjësinë tonë të përbashkët për të krijuar një mjedis më të sigurt për të gjithë! Ngushëllime të sinqerta të gjithë familjarëve, miqve dhe të afërmeve të tyre!", ka thënë Rama. Për rastin kanë shprehur keqardhje shumë figura të larta politike në Kosovë.

Bedri Hamza: Mbështetje 80 % të pagës për 6 muaj për ata që humbin vendin e punës



PRISHTINË, 2 SHKURT - Kandidati i PDK-së për kryeministër, Bedri Hamza, ka vazhduar shpalosjen e programit edhe këtë të diel. Hamza ka postuar në rrjetet sociale një video, ku një menaxher lokal tregon që frika e tij është humbja e vendit të punës. Ai thotë se nuk mund ta paramendojë si do të gjendej nëse mbetet pa të ardhura derisa të gjejë një vend tjetër pune. Hamza ka thënë se humbja e vendit të punës krijon pasiguri te secili qytetar, por me mbështetjen e shtetit do ta kenë më të lehtë. "Humbja

e vendit të punës krijon pasiguri te secili qytetar, por me mbështetjen e shtetit do ta keni më të lehtë. Unë do ta krijoj Fondin për Papunësinë për ta mbështetur mirëqenien e fuqisë punëtore, duke ndihmuar qytetarët t'i përballojnë nevojat e përditshme të jetesës në rast humbjeje të punës. Për 6 muaj me radhë, nëse mbeteni të papunë, përpos me trajnime profesionale për zhvillimin e aftësive, do të mbështetni edhe me 80% të pagës së fundit që e keni marrë", ka shkruar Hamza.

KQZ-ja fillon trajnimin e më se 15 mijë anëtarëve të Këshillave të Vendvotimit në Kosovë dhe në përfaqësi diplomatike

PRISHTINË, 2 SHKURT - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka filluar fazën e radhës të programit të trajnimit, në të cilën përfshihet trajnimi i anëtarëve të Këshillave të Vendvotimit të cilët do të angazhohen në ditën e zgjedhjeve më 9 shkurt 2025. Sipas njoftimit, thuhet se për herë të parë do të mbahet

programi i trajnimit për anëtarët e Këshillave të Vendvotimit të cilët do të angazhohen për votimin jashtë Kosovës më 8 shkurt 2025 në vendvotimet që do të hapen në përfaqësitë diplomatike. Në këtë fazë të trajnimit do të përfshihen më shumë se 15 mijë anëtarë të Këshillave të Vendvotimit, të cilët janë

emëruar nga KQZ dhe që u përkasin të gjitha komunave të Republikës së Kosovës. Qëllimi i këtij trajnimi është që anëtarët e Këshillave të Vendvotimit të përfitojnë njohuri mbi legjislacionin, rregulloret zgjedhore dhe procedurat zgjedhore që do t'i zbatojnë në ditën e zgjedhjeve për temat të ndryshme.





DnV-ja vëren shtim të fushatës, të shpenzimeve dhe gjuhës së urrejtjes

Gjatë javës së fundit ka pasur përkeqësim të mëtutjeshëm të gjuhës dhe diskursit të përdorur në fushatë. Numri i aktiviteteve ku është përdorur gjuhë fyese, nxitëse apo e urrejtjes pothuajse është dyfishuar, me 48 raste të evidentuara vetëm këtë javë. Aktivitetet e organizuara nga LV-ja prijnë për nga numri i rasteve kur është përdorur gjuha e urrejtjes. Pas saj renditen AAK-ja, PDK-ja dhe LDK-ja

**EPOKA
ERE** **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 2 SHKURT - Rrjeti i organizatave joqeveritare në Kosovë, Demokracia në Veprim (DnV), ka thënë se në javën e tretë të fushatës zgjedhore për zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit është vërejtur shtim i aktiviteteve partiake. Ky rrjet ka thënë se është shtuar edhe gjuha nxitëse dhe e urrejtjes. Fushata zgjedhore ka nisur zyrtarisht më 11 janar dhe do të zgjasë deri në ditën kur të hapen qendrat e votimit. Sipas DnV-së, fushata në javën e tretë ka qenë e qetë, përveç një rasti në Skenderaj, ku është tentuar të pengohet një tubim i Lëvizjes Vetëvendosje. Disa qytetarë atje kanë tentuar ta pengojnë grumbullimin e këtij subjekti partiak dhe kanë përdorur mjete piroteknike. Violeta Haxholli nga DnV ka tërhequr vërejtjen që situata të tilla rrezikojnë të përsëriten në ditët e fundit të fushatës, kur partitë politike të organizojnë takime përmbyllëse. Ajo ka thënë se organizata që përfaqëson e ka dënuar incidentin në Skenderaj,

pasi ka qenë në kundërshtim me lirinë e grumbullimit dhe parimet e demokracisë, dhe i ka thirrur subjektet politike në përgjegjësi, duke u kërkuar të përmbahen nga gjuha nxitëse. Disa qytetarë kanë protestuar para vendit ku ishte planifikuar të deklarohet Albin Kurti - kryeministër i Kosovës, i cili synon edhe një mandat në këtë pozitë - si dhe janë dëgjuar duke bërë thirrje për "Thaçi, Thaçi", referencë për ish-presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi, dhe ish-kryetarin e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), që tradicionalisht ka qenë në krye të garës në Skenderaj. Në zgjedhjet e vitit 2021 PDK-ja pati siguruar 70.9 për qind të votave në këtë komunë, ndërsa Lëvizja Vetëvendosje 20 për qind. Mes të tjerash, Haxholli ka përmendur se në javën e tretë të fushatës është rritur edhe numri i shpenzimeve të partive për sponsorime në rrjetet sociale - në vlerë të rreth 50 mijë eurove. Partitë politike në Kosovë kanë të drejtë të shpenzojnë mbi dy milionë euro në fushatën për zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit, ose jo më pak se një euro për një votues të regjistruar.

Kështu është e përcaktuar me rregulloren e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), e miratuar në muajin gusht të vitit të kaluar. Rregullorja specifikon se në zgjedhjet e përgjithshme, ato lokale dhe për kryetarë të komunave, kufizimi i shpenzimeve do të jetë në jo më pak se një euro për votues. Partitë politike financohen nga dy burime - nga buxheti i shtetit dhe nga donatorët e jashtëm - në formë të parave të gatshme ose përmes kontributeve në mallra dhe shërbime. Financimi nga buxheti i shtetit bëhet çdo vit përmes Fondit për Mbështetjen e Subjekteve Politike. Ky fond në buxhetin e këtij viti - prej 3.6 miliardë eurosh - ka vlerën e 4.8 milionë eurove. Mjetet nuk janë shpërndarë ende për këtë vit, sepse rekomandimi i propozuar nga Zyra e Partive Politike në kuadër të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nuk i ka marrë votat e nevojshme nga anëtarët e KQZ-së. Përpjekje të reja priten të ketë në muajt në vazhdim. Fondi për Mbështetjen e Subjekteve Politike e kishte vlerën e njëjtë edhe vitin e kaluar: 4.8 milionë euro. Ndarja bëhet në bazë të përfaqësimit të partive politike në Kuvendin e Kosovës, që ka gjithsej 120 ulëse. Me Rregulloren për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar, partitë politike kanë të drejtë të pranojnë

kontribute shtesë për fushatë nga persona fizikë dhe juridikë. Personat fizikë mund të japin deri në 2 000 euro, ndërsa ata juridikë jo më shumë se 10 000 euro. Vëzhguesit e zgjedhjeve kanë ngritur shqetësime disa herë për transparencën e donacioneve që marrin partitë politike. Në konferencën e DnV-së, Haxholli ka treguar edhe se vlera e gjobave të lëshuara nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP) për partitë politike ka shkuar në mbi 432 mijë euro përgjatë gjithë fushatës zgjedhore. Lidhja Demokratike e Kosovës është gjobitur më së shumti, me mbi 113 mijë euro, më pas Lëvizja Vetëvendosje me 101 mijë euro, të pasuara nga Partia Demokratike e Kosovës me 87 mijë euro, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës me 69 mijë euro, dhe disa parti të tjera më të vogla.

Fushata në numra

Deri më tani DnV ka monitoruar 582 aktivitete të subjekteve politike në tërë vendin, prej të cilave 207 janë mbajtur vetëm në javën e fundit. Tashmë me numrin më të madh të aktiviteteve prin PDK-ja, me 165 aktivitete, e cila ka tejkaluar LDK-në që ka 151 aktivitete. Lëvizja Vetëvendosje ka mbajtur 120 aktivitete, AAK-ja 89 aktivitete, ndërsa subjektet e tjera politike (përfshirë edhe ato nga radhët e komuniteteve) kanë mbajtur rreth 60 tubime publike. Tubime kanë organizuar edhe partitë nga

komuniteti serb në Kosovë, ku në këto zgjedhje, për dallim nga zgjedhjet e kaluara kur garonin vetëm tri partitë e vogla serbe, në këto zgjedhje në garë janë 6 parti. Fushata e tyre është duke u zhvilluar në të gjitha komunat serbe.

Fushata në hapësirën online

DnV deri më tani ka monitoruar në total 679 kandidatë për deputetë, prej të cilëve 447 janë burra dhe 232 gra. Gjatë tri javëve të fushatës janë identifikuar deri në 623 raste të i) gjuhës denigruese dhe nxitjes së urrejtjes, veçanërisht në videot e realizuara nga subjektet politike dhe të shpërndara në rrjetet sociale; ii) Gjuhës së urrejtjes dhe përçmuese nga palët e treta, të cilat shpesh shfaqen në komentet e postimeve të kandidatëve për deputet/e; iii) Lajmeve të pavërteta, të cilat krijojnë dezinformim dhe përhapi mesazhe që rrezikojnë integritetin e fushatës. Nga këto në total 232 raste apo 37 % e rasteve kanë pasur target gratë e subjekteve politike. Paralelisht është bërë monitorimi i 152 portaleve (mediave online) në gjuhën shqipe dhe serbe, ku janë identifikuar mbi 130 000 komente të bëra, prej të cilave 6% përmbajnë gjuhë urrejtjeje drejt subjekteve politike. Këto pasqyrojnë përdorimin e gjuhës së urrejtjes në komunikimet politike, duke ndikuar negativisht në diskursin publik dhe demokratik të vendit.

Fushata zgjedhore: Me metoda tradicionale premtojnë arsim modern

Prishtinë, 2 shkurt - Fjalimet në fushatën zgjedhore në Kosovë janë të gjata dhe të zhurmshme, por rrallë për arsimin. Kandidatët politikë kanë përqendruar vëmendjen te rritja ekonomike, hapja e vendeve të reja të punës, mbështetja për bizneset, sulmet për njëri-tjetrin... Për arsimin - njërën prej shtyllave kryesore të shoqërisë - dëgjohej më pak. Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, i cili në zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit do të garojë për mandatin e dytë, ka thënë para katër vjetësh se investimi në arsim do të jetë “preokupim kryesor” i qeverisë së tij. Është zotuar se do të investojë në shkolla e çerdhe publike, do të trajnojë mësimdhënës e do të punësojë të rinj. “Për herë të parë do të kemi një program i cili shkollat i sheh si vend i dijes për fëmijët e rininë, ku pasurohet shoqëria e fiton shteti, e jo si tender ku pasurohet individi apo familjarët”, ka thënë Kurti në vitin 2021. Qeveria e Kurtit, përkatësisht Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), ka miratuar edhe Strategjinë e Arsimit 2022-2026, ku ka përcaktuar pesë objektiva strategjike – mes tyre digjitalizimin e arsimit. Për këtë proces janë ndarë edhe 52 milionë euro, por ndikimi në praktikë i premtimeve - disa vjet pas nuk është ende aq i dukshëm. Në Shkollën Fillore “Pavarësia” në Prishtinë, mësimdhënia dhe mësimnxënia vazhdojnë me metodat tradicionale - qoftë nga mënyra e shpjegimit në

dërrasë të zezë, qoftë nga organizimi i nxënësve në klasë. Me më shumë se 1 900 nxënës, “Pavarësia” është ndër shkollat më të mëdha fillore në Prishtinë. Ushtruesi i detyrës së drejtorit të saj, Halil Brahaj, thotë për programin Expose të Radios Evropa e Lirë se shkolla ka vetëm një kabinet me kompjuterë, të cilët shfrytëzohen vetëm nga nxënësit që kanë lëndë të teknologjisë informative dy-tri herë në javë. “Në kabinetin e teknologjisë kemi kompjuterë për një klasë të mjaftueshme. Njëzet kompjuterë i kemi të rinj, që i ka sjellë komuna e Prishtinës, ndërsa të tjerët janë donacione nga shoqata të ndryshme, banka, fakultete e kështu me radhë. Ata janë të përdorur, por të domosdoshëm”, thotë Brahaj. Regjistrimi i popullsisë në Kosovë vitin e kaluar ka treguar se në sistemin e arsimit parauniversitar mësimet i ndjekin rreth 300 mijë nxënës në më shumë se 1 000 shkolla. Sipas të dhënave të fundit në Strategjinë e Arsimit, në këto shkolla ka mbi 9 000 kompjuterë, apo mesatarisht 1 kompjuter për 35 nxënës. Shifrat nuk janë të krahasueshme me ato në vendet e BE-së, ku një kompjuter në shkollë është në dispozicion për 3 deri në 7 nxënës. Radio Evropa e Lirë pyeti MASHTI-n se sa mjete të parapara për digjitalizimin e shkollave janë shpenzuar deri më tani, por nuk mori përgjigje. Brahaj thotë se shkolla që udhëheq, “Pavarësia”, deri vonë është përballur edhe me sfida të tjera, jashtë aspektit të

digjitalizimit. “Nga shtatori i vitit të kaluar ne i jemi kthyer normalitetit, sepse ‘Pavarësia’ për dy vjet radhazi ka punuar në tri ndërrime për shkak të mungesës së hapësirës, gjegjësisht rritjes së vazhdueshme të numrit të nxënësve. Me përfundimin e aneksit është krijuar paksa komoditet për të pasur hapësira edhe për kabinete”, thotë Brahaj. Me sfida të ngjashme të organizimit përballen edhe shumë shkolla të tjera publike në Kosovë, derisa cilësia e arsimit mbetet e dobët. Në tri teste të PISA-s - program ndërkombëtar për vlerësimin e nxënësve në lexim, shkencë e matematikë - që janë zhvilluar më 2015, 2018 dhe 2022, Kosova ka dalë gati në fund të listës botërore. Për më tepër, rezultati ka shkuar duke u përkeqësuar, e jo duke u përmirësuar. Ministria e Arsimit, Arbërie Nagavci, në atë kohë ka fajësuar pjesërisht pandeminë Covid-19 për situatën e krijuar. Tani partitë që synojnë pushtetin në zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit kanë nxjerrë zotime të ndryshme për arsimin në programet e tyre. Në atë që ka publikuar Lëvizja Vetëvendosje e Kurtit thuhet vetëm se ai do të sigurojë “bono për prindërit që i dërgojnë fëmijët në çerdhe jopublike”. Partia Demokratike e Kosovës, e cila garon me Bedri Hamzën për kryeministër, ka një program më të hollësishëm për këtë çështje, ku, mes të tjerash, zotohet se do ta avancojë kurrikulën, do të përfshijë materiale digjitale në mësim, do t'i pajisë nxënësit dhe mësimdhënësit me laptopë, do

t'i trajnojë dhe vlerësojë mësimdhënësit e të tjera. Plani për arsim i Lidhjes Demokratike të Kosovës - e cila kandidat për kryeministër ka Lumir Abdixhikun - parasheh rritjen e numrit të çerdheve, riorganizimin e shkollave, fuqizimin e shkollave profesionale, ndërlidhjen e arsimit me tregun e punës, themelimin e Fondit të Shkencës dhe Fondit të Ekselencës e të tjera. Ndërsa Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës - me kandidat për kryeministër Ramush Haradinajn - zotohet se do t'i rrisë shërbimet në arsim, për të kapërcyer, siç thotë, hendekun digjital dhe për ts aftësuar rininë. Për AAK-në arsimi duhet të ngrihet në nivel të konkurrueshëm me vendet perëndimore. Për ekspertët e çështjeve të arsimit të gjitha këto janë të realizueshme, vetëm se duhet vullnet politik për të shkuar përtej narrativit elektoral, që deri më tash ka munguar, sipas tyre. Rinor Qehaja, drejtor ekzekutiv i Institutit Ed Gurad në Prishtinë, përmend metodat e vjetruara të mësimdhënies si pengesë kryesore drejt përparimit. Duke folur për Exposedenë, ai thotë se ndryshimi duhet të fillojë prej aty. “Logjika në mësimdhënie dhe mësimnxënie në Kosovë e ka një prani minimale. Ende mësohen vjersha përmendësh, përgjigjet janë me data, emra e mbiemra. Nuk ka pyetje që nxit mendim kritik, nuk ka pyetje dhe mësimnxënie që nxisin logjikë. Në momentin kur këta nxënës të ballafaqohen me një test të standardizuar si PISA, që shtrun pyetje të logjikshme dhe

që kërkojnë përgjigje të logjikshme, atëherë padysim se ata do ta kenë atë performancë”, thotë Qehaja. Për Xhavit Rexhajn, profesor në Kolegjin AAB në Prishtinë, në arsimin në Kosovë “duhet shpallur gjendje e jashtëzakonshme”. Në kohën e bumit digjital dhe të inteligjencës artificiale ai thotë se mësimdhënësit në vend shkojnë ende me shkumësa në klasë. Këtë situatë ai e quan “padrejtësi ndaj fëmijëve”. “Ku e ke identifikimin e talenteve, ku e ke mbështetjen e talenteve, ku e ke mbështetjen e nxënësve me nevoja të veçanta, ku i ke aktivitetet, klubet, ku identifikohen talentet, ku i ke mjetet që nxënësit të organizohen në klube të gjelbra, klube të shkencës, klube të debatit, klube të artit, klube të muzikës, ku i ke orkestrat muzikore në shkolla? Ne tallemi me arsimin në Kosovë, nuk jemi aspak seriozë. Këto programe që i kam lexuar, janë deklarata pozitive, afirmative, por nuk e kanë parasysh dhimbjen e arsimit kosovar sa duhet”, thotë Rexhaj. Ai thekson se ndryshimi duhet të nisë me kurrikulat. Kosova, sipas tij, duhet ta themelojë Agjencinë për Kurrikula, sepse është e papranueshme që “vetëm tre-katër veta” të merren me to. Për më tepër, ato janë edhe të vjetruara, thotë Rexhaj. Në Kosovë ndryshimet kurrikulare kanë nisur në vitin 2001, ndërsa gjatë viteve 2008-2016 janë miratuar dhe hartuar Korniza e Kurrikulës së Kosovës, kurrikulat bërthamë dhe programet lëndore.



Peter Sorensen si pasardhës i Miroslav Lajçakut në dialogun Kosovë - Serbi, shpresa dhe pritshmëritë



Shkruan: prof.
dr. Fejzulla BERISHA

1. Konteksti i emërimit të Peter Sorensen

Pas përfundimit të mandatit të Miroslav Lajçakut, Bashkimi Evropian ka vendosur që diplomati danez Peter Sorensen të jetë përfaqësues i ri i posaçëm për dialogun Kosovë - Serbi. Ky ndryshim vjen në një kohë kur procesi i dialogut ka ngecur, veçanërisht për shkak të mungesës së zbatimit të marrëveshjeve të arritura më parë.

Sorensen ka një përvojë të gjatë diplomatike në Ballkan dhe në institucionet e BE-së, duke shërbyer më parë si: Përfaqësues i Posaçëm i BE-së për Bosnje dhe Hercegovinën dhe shef i delegacionit të BE-së në Sarajevë. Shef i delegacionit të BE-së në Maqedoninë e Veriut. Këshilltar në Misionin e Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK). Përfaqësues i posaçëm i BE-së në Serbi. Pikërisht përvoja e tij në rajon ka bërë që BE-ja ta shohë atë si figurën më të përshtatshme për

të marrë përsipër këtë detyrë të ndjeshme diplomatike.

2. Gjendja aktuale e dialogut Kosovë - Serbi

Dialogu mes Kosovës dhe Serbisë, i ndërmjetësuar nga BE-ja që nga viti 2011, ka kaluar në disa faza të vështira. Marrëveshjet më të rëndësishme të arritura deri më sot përfshijnë: Marrëveshja e Brukselit (2013): Themeloi bazën për normalizimin e marrëdhënieve dhe për krijimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë. Ky asociacion ende nuk është implementuar për shkak të kundërshtimeve të Qeverisë së Kosovës. Marrëveshja për Energjinë (2015, 2022): Përfshinte rregullimin e çështjes së furnizimit me energji elektrike në komunat veriore të Kosovës. Marrëveshja e Ohrit (2023): Një marrëveshje ligjërish të obligueshme për normalizimin e marrëdhënieve, e cila parashihte njohje de facto, por që nuk është zbatuar plotësisht nga të dyja palët. Megjithatë, shumica e këtyre marrëveshjeve ose janë zbatuar pjesërisht ose nuk janë implementuar fare, duke krijuar tensione të vazhdueshme.

3. Raste konkrete të ngecjes në dialog dhe implikimet

Për të kuptuar sfidat që Peter Sorensen do të trashëgojë nga

Lajçaku, ja disa raste konkrete që kanë penguar përparimin në dialog:

a) Moszbatimi i Asociacionit të Komunave Serbe.

Serbia insiston në krijimin e Asociacionit si një hap kyç për avancimin e dialogut. Kosova, veçanërisht nën udhëheqjen e Albin Kurtit, e kundërshton këtë duke e cilësuar si një mekanizëm që do të krijonte një entitet serb brenda Kosovës, të ngjashëm me Republikën Srpska në Bosnje. Ky ngërç ka çuar në ndërprerje të bisedimeve të nivelit të lartë dhe ka tensionuar marrëdhëniet me BE-në dhe ShBA-në.

b) Kriza në Veri të Kosovës (2023-2024).

Pas zgjedhjeve lokale në veri të Kosovës (prill 2023), të cilat u bojkotuan nga serbët, kriza u thellua. Serbia vazhdoi të mbështesë strukturat paralele në veri, ndërsa Qeveria e Kosovës vendosi t'i zëvendësonte me institucione të ligjshme të Kosovës. Incidentet me dhunë, përfshirë sulmin e grupeve të armatosura serbe ndaj policisë së Kosovës në Banjskë (shtator 2023), përshkallëzuan situatën, duke e bërë dialogun edhe më të vështirë.

c) Negociatat për njohjen reciproke.

Kosova kërkon njohje të plotë nga Serbia, ndërsa Serbia

refuzon të bëjë një hap të tillë, duke insistuar në një qasje më të butë të normalizimit të marrëdhënieve. BE-ja dhe SHBA-ja kanë propozuar modele të njohjes de facto, të ngjashme me marrëdhëniet mes Gjermanisë Lindore dhe Perëndimore në të kaluarën.

Serbia, megjithatë, ka intensifikuar fushatën diplomatike kundër njohjeve të Kosovës në arenën ndërkombëtare.

4. Çfarë pritet nga Peter Sorensen?

Me këtë sfond kompleks, Peter Sorensen do të përballet me një detyrë të vështirë. Disa nga pritshmëritë për të përfshijnë: Rritja e presionit për zbatimin e marrëveshjeve - BE-ja, nën udhëheqjen e Kaja Kallas, mund të ndjekë një qasje më të ashpër ndaj palëve që nuk zbatojnë marrëveshjet. Zbutja e tensioneve në veri të Kosovës - Sorensen mund të propozojë hapa konkretë për zgjidhjen e krizës në veri, duke kërkuar angazhimin e drejtpërdrejtë të komunitetit serb në Kosovë. Bashkëpunim më i ngushtë me ShBA-në. Me ndryshimin e administratës amerikane (pasi që kemi të bëjmë me rikthimin e Donald Trump në pushtet), mund të ketë një riorientim të politikës amerikane ndaj Ballkanit, gjë që do të ndikojë edhe në dialog. Rruga e Kosovës drejt BE-së.

Një nga objektivat kryesore të dialogut është të ndihmojë Kosovën dhe Serbinë në integrimin evropian. Megjithatë, Serbia ka treguar më shumë përparim në këtë drejtim, ndërsa Kosova ende nuk ka fituar statusin e kandidatit për anëtarësim në BE.

5. Shpresa për një kapitull të ri në dialog.

Emërimi i Peter Sorensen shihet si një mundësi për të ringjallur procesin e dialogut, i cili gjatë mandatit të Lajçakut shpesh u konsiderua i dështuar. Diplomacia e tij pragmatike dhe njohja e mirë e rajonit mund të ndihmojnë në ndërtimin e një qasjeje më të balancuar. Megjithatë, suksesi i tij do të varet nga disa faktorë kyç: Angazhimi i Kosovës dhe Serbisë për të zbatuar marrëveshjet. Ndihma e SHBA-së dhe BE-së në garantimin e zbatimit të dialogut. Menaxhimi i tensioneve në terren për të shmangur përshkallëzimin e dhunës. Nëse Sorensen arrin të krijojë një dinamikë të re dhe të sigurojë zbatim konkret të marrëveshjeve, atëherë do të ketë një shans real për ta çuar përpara procesin e normalizimit mes Kosovës dhe Serbisë. Në të kundërt, dialogu mund të vazhdojë të mbetet i bllokuar, me pasojë të mëdha për stabilitetin rajonal.

Orav: Përvoja e Sorensenit do të ndihmojë në normalizimin e marrëdhënieve Kosovë - Serbi

PRISHTINË, 2 SHKURT - Ambasadori i Bashkimit Evropian në Kosovë, Aivo Orav, ka zhvilluar një takim shumë të mirë me Peter Sorensenin, të dërguarin e ri të Bashkimit Evropian për dialogun mes Kosovës dhe Serbisë. Për dallim nga paraardhësi i tij, Miroslav Lajçaku, Sorensen do të merret vetëm me dialogun dhe jo me çështje të tjera të Ballkanit. Ai e ka nisur zyrtarisht mandatin më 1 shkurt. Orav ka thënë përmes një postimi në rrjetin social X se beson që përvoja diplomatike e Sorensenit do t'i ndihmojë në avancim të normalizimit të marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë. "Ekipi im dhe unë e mbështesim atë plotësisht!", ka thënë Orav. Prej kur ka nisur të lakohet emri i Sorensenit në media, javë më

parë, atmosfera për të ka qenë pozitive. Një prej argumenteve më të shpeshta ka qenë se 57-vjeçari e njeh rajonin. Dhe, njëmend ashtu është. Diplomati prej shumë vitesh, ai ishte angazhuar në Kosovë, në kuadër të Misionit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (UNMIK), si dhe në role tjera, në Serbi, Maqedoni të Veriut dhe Bosnjë e Hercegovinë. Siç thonë edhe njohësit e politikës, ai nuk ka nevojë që të informohet paraprakisht për njerëzit apo faktet historike të rajonit, sepse tashmë ka pasur mundësinë ta krijojë një pasqyrë nga afër. Një tjetër argument që është përmendur si pozitiv nga zyrtarët në Prishtinë është se ai është nga Danimarka, vend që njeh shtetësinë e Kosovës, dhe



se do të ketë qasje të barabartë në dialog. Prejardhja e një ndërmjetësuesi është kthyer në element shumë të rëndësishëm, prej kur atë pozitë e pati marrë Lajçaku, ndërsa atë të kryediplomatit të BE-së e ka mbajtur Josep Borrell. Duke qenë njëri nga Sllovakia, dhe tjetri nga Spanja, të dyja vende mosnjohëse të shtetësisë

së Kosovës, ata i ka ndjekur vazhdimisht një hije e zezë. Nga qytetari i thjeshtë i Kosovës deri te presidentja e vendit, Vjosa Osmani, dyshja është akuzuar për njëanshmëri dhe për rreshtim, me raste, nga Serbia. Të dy i kanë mohuar vazhdimisht akuzat. Megjithatë, njohësit e çështjeve politike nuk presin mrekulli në

procesin e dialogut, meqë besojnë se suksesi në dialog varet nga energjia që shpenzojnë vendet kryesore të BE-së në këtë proces, sidomos Gjermania dhe Franca. Por, ato tani po përballen me kriza të brendshme politike dhe, rrjedhimisht, Sorensen nuk do të ketë fuqinë politike mbrapa vetes që ndoshta do ta dëshironte. Fokusi në dialog pritet të jetë në zbatimin e marrëveshjes për normalizim të marrëdhënieve, të arritur mes dy palëve në shkurt të vitit 2023. Palët negociojnë qysh prej vitit 2011 dhe kanë arritur një mori marrëveshesh, por jo të gjitha janë zbatuar. BE-ja ua rikujton të dyja palëve shpesh se avancimi në procesin e dialogut është i lidhur me rrugën e tyre drejt integritimeve euroatlantike.

Premtimet për rrymën: Gaz, thëngjill, burime të ripërtërishme

PRISHTINË, 2 SHKURT - Gjatë muajit dhjetor të vitit të kaluar shumë qytete të Kosovës u përballën me ndërprerje të energjisë elektrike. Në disa prej tyre ky problem zgjati me ditë. Arsyetimi i institucioneve ishte mbingarkesa në rrjetin energjetik të Kosovës. Tani që fushata zgjedhore për zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit po vazhdon, partitë politike po premtojnë rregullimin e këtij problemi për të pasur furnizim të plotë me rrymë.

Termocentral me gaz, termocentral me thëngjill e hidrocentrale, janë disa nga zgjidhjet që po i përmendin katër kandidatët për kryeministër.

Bedri Hamza, kandidat për kryeministër nga Partia Demokratike e Kosovës, gjatë një vizite në hidrocentralin e Orqushës në rajonin e Dragashit, premtoi lehtësim të procedurave për ata që duan të investojnë në hidrocentrale. “Do ta krijojmë një institucion, një agjenci ‘one-stop-shop’, ku të gjithë të interesuarit për të investuar në sektorin e prodhimit të energjisë do të pajisen me leje dhe dokumentacion”, tha Hamza.

Në fushatë Hamza ka përmendur edhe ndërtimin e një centrali me gaz që, sipas tij, do të mund të ndikonte në përmirësimin e furnizimit me energji elektrike.

Pikë kyç e programit të tij, kandidati i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku, ka investimin në prodhim të energjisë elektrike me gaz. “Ne do ta ndërtojmë centralin e ri me gaz në Ferizaj. 500 milionë euro investim për centralin me gaz amerikan”, tha Abdixhiku.

Ramush Haradinaj, kandidat për kryeministër nga Koalicioni AAK-NISMA-Konservatorët, qëndron pas idesë për të ndërtuar një termocentral të ri me thëngjill.

“Po ta kishim ndërtuar ne një 500 megavatësh me qymyr - unë s’jam për energji me qymyr se e di që ka ndotje, ama mos harroni teknologjia e re sot nuk ndot, besoni e ka një për qind emetim”, tha Haradinaj gjatë një tubimi zgjedhor në Klinë.

Për dallim nga Hamza, Abdixhiku dhe Haradinaj, kryeministri aktual dhe kandidati për kryeministër i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, në fjalimet e tij gjatë fushatës nuk ka folur shumë për fushën e energjisë.

Në disa raste ka përmendur një park energjetik për Vushtrrinë dhe vënien në funksion të sistemit të baterive akumuluese nga granti amerikan i Korporatës së Sfidave të Mijëvjeçarit -

MCC. “Kosova do të ketë një miks të energjisë, që bazohet në burime vendore dhe gjithnjë e më shumë në burime të pastra të ripërtërishme nga era dhe dielli”, tha Kurti në shpalosjen e programit zgjedhor më 25 janar.

Qeveria e drejtuar nga Kurti së fundi ka shpallur projektin në vlerë të 137 milionë eurove për rehabilitimin e njësishë 3A të termocentralit Kosova A.

Të tre liderët në deklarimet e tyre kanë përmendur edhe zgjidhje të tjera që përfshijnë zgjerimin e burimeve për prodhim të energjisë së ripërtërishme.

Sa përputhen këto premtime me objektivat klimatike të BE-së?

Disa prej këtyre planeve bien ndesh me objektivat e Bashkimit Evropian që deri në vitin 2050 vendet që synojnë anëtarësimin duhet të kenë zero emetim të dyoksidit të karbonit.

Sipas organizatës mjedisore Bankwatch Network me seli në Pragë të Çekisë, prodhimi i energjisë elektrike në një central me gaz siç planifikojnë PDK-ja dhe LDK-ja nuk është zgjidhje e duhur për Kosovën. “Gazi është shumë-shumë i shtrenjtë për t’u përdorur për energjinë bazë veçanërisht, sepse do të ketë gjithnjë e më shumë energji diellore dhe të erës, të cilat kanë kosto operimi jashtëzakonisht të ulët”, tha Pippa Gallop, zyrtare për politikat energjetike në Bankwatch Network.

Gallop thotë se centralet me gaz kanë një kosto të lartë të operimit. “Edhe nëse termocentrali me gaz ndërtohet, përdorimi i tij do të jetë jashtëzakonisht i shtrenjtë, sepse gazi që do të marrim tani, nuk do të jetë i lirë si gazi rus. Gazi amerikan është gaz i lëngshëm, i cili duhet të përpunohet”, thotë Gallop.

Përveç se i kushtueshëm, Gallop thotë se ndërtimi i një centrali me gaz parashihet të zgjasë deri në dhjetë vjet dhe konsiderohet shumë e vonë si ide, bazuar në politikat klimatike të Bashkimit Evropian. “Si pjesë e objektivave klimatike të BE-së, gazi do të duhet të hiqet gradualisht. Dhe kjo duhet të ndodhë më së voni deri në vitin 2050. Pra, kushdo që tani po propozon të fillojë të ndërtojë termocentrale me gaz, ka ardhur me të vërtetë 20 vjet me vonesë në histori”, shtoi Gallop.

Qeveria e drejtuar nga Albin Kurti në fillim të mandatit e refuzoi ndërtimin e rrjetit të gazsjellësit, me arsyetimin se ka një kosto të lartë prej rreth 600 milionë eurosh, ndërkohë



që Korporata e Sfidave të Mijëvjeçarit - MCC ishte zotuar për një grant prej 200 milionë eurosh.

Në programet e tyre zgjedhore partitë politike i shpjegojnë më hollësisht planet për prodhimin të energjisë, përveç Vetëvendosjes që deri më tani pa publikuar pjesëza të programit.

Çfarë shkruhet në programet e partive për rrymën?

Vetëvendosja në një pjesë të programit, përveç modernizimit të termocentralit Kosova B, përmend edhe ndërtimin e kapaciteteve të përbashkëta me Shqipërinë, si dhe investime të tjera në energji të ripërtërishme. “Termocentrali Kosova A do të modernizohet, ndërsa Termocentrali Kosova B do të rehabilitohet thellësisht ashtu që të rritet siguria e furnizimit dhe të ulët ndjeshmëria ndaj krizave eventuale nga jashtë”, thuhet në programin e Vetëvendosjes.

PDK-ja fokusohet për prodhimin e energjisë elektrike nga një termocentral me gaz dhe investime në hidrocentrale. “Planifikojmë ndërtimin e termocentralit me gaz me një kapacitet prej 350 MW krahas lidhjeve me tubacione me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut”, thuhet në programin zgjedhor të PDK-së.

Kosova që ka resurse të pakta ujore ka një përvojë jo aq të mirë të ndërtimit të hidrocentraleve për shkak të degradimit të lumenjve. Pavarësisht prej kundërshtimit të banorëve të Deçanit dhe Shtërpçës, në rrjedhën e Lumëbardhit dhe Lepencit u ndërtuan hidrocentrale që shkaktuan dëme të shumta në mjedis.

LDK-ja në programin e saj parasheh ndërtimin e centralit me gaz, i cili do të pasonte mbylljen e termocentralit Kosova A. “Ky lloj centrali do të

përdoret edhe për nevoja momentale të furnizimit me energji elektrike, edhe për nevoja të balancimit të sistemit të furnizimit me energji elektrike”, thuhet në programin e LDK-së.

Por, centralet me gaz përveçse kanë kosto të lartë të ndërtimit, kanë kosto të lartë të mirëmbajtjes dhe në rastet kur çmimi i gazit rritet, rritet edhe kostoja e prodhimit të energjisë elektrike. LDK-ja dhe PDK-ja ofrojnë edhe alternativa të tjera të prodhimit të energjisë së ripërtërishme për ta zëvendësuar prodhimin e rrymës nga djegia e thëngjillit. AAK-ja është e vetmja që premton ndërtimin e një termocentrali të ri me thëngjill krahas idesë për ndërtimin e rrjetit të gazsjellësit.

Në programin e saj listohen disa masa dhe veprime, pa dhënë sqarime se si do të bëhen. “Energji efikase, që ofron furnizim të vazhdueshëm, të stabilizuar dhe me çmim të përbalueshëm; ulja e TVSh-së së energjisë elektrike në nivelin 6 % për përdoruesit familjarë.”

Burimet e rrymës në Kosovë

Aktualisht Kosova ka dy termocentrale me thëngjill, të cilat prodhojnë mbi 90 për qind të energjisë elektrike. Termocentrali Kosova A u vu në funksion në vitin 1962.

Sipas të dhënave nga Korporata Energjetike e Kosovës, aktualisht janë në funksion vetëm blloqet A3, A4 dhe A5 të këtij termocentrali. Prodhimi vjetor nga ky termocentral është rreth 1 500GW/h.

Kurse termocentrali Kosova B përbëhet nga dy njësi gjeneruese të njohura si njësia B1 dhe B2. Sipas një raporti të Bankës Botërore për klimën dhe zhvillimin e Kosovës i publikuar në dhjetor të vitit 2024, infrastruktura e vjetruar e termocentraleve me thëngjill është një ndër faktorët

kryesorë të degradimit të mjedisit.

Në 25 vjetët e ardhshme Kosova synon dekarbonizimin bazuar në Marrëveshjen e Gjellbër për Ballkanin e nënshkruar në Samitin e Sofjes.

Kurse janë aktive dy parqe të energjisë me erë, në Bajgorë të Mitrovicës së Jugut dhe në Kitkë të Kamenicës.

Së fundi, pati një fitues nga ankandi i parë solar prej 100 megavatësh.

Pipa Gallop nga organizata mjedisore Bankwatch Network thotë se Kosova duhet sa më shpejt ta zgjerojë prodhimin e energjisë nga dielli dhe era. “Kosova duhet ta përshpejtojë procesin e instalimit të energjisë diellore dhe asaj të erës - në të ardhmen këto burime do ta përbëjnë pjesën më të madhe të prodhimit aktual të energjisë. Kjo mund të duket e pabesueshme për një vend që aktualisht varet deri në 90 për qind nga qymyri, por kjo është ajo që po ndodh në mbarë Evropën me energjinë diellore dhe atë të erës”, thotë Gallop.

Jo vetëm Kosova, por edhe vende të tjera të botës u përballën me pasiguri energjetike në vitin 2022 kur Rusia nisi pushtimin e paprovokuar të Ukrainës. Lufta shkaktoi pasiguri në furnizim me gaz dhe rritje të çmimit të energjisë elektrike. Kosova e kaloi pa shumë pasojë këtë krizë, por në fund të vitit të kaluar qytete e fshatra u përballën me mungesë të theksuar të rrymës.

Qeveria insistoi se nuk pati mungesë të energjisë, por tha se ndër vite është rritur konsumi dhe si pasojë rrjeti elektrik nuk e përballoi mbingarkesën.

Strategjia e Energjisë e Kosovës për periudhën 2022 - 2031 parasheh një tranzicion gradual drejt reduktimit të varësisë nga termocentralet me bazë qymyrin, si dhe mbylljen e Kosovës A deri në vitin 2028, por zbatimi i këtyre planeve do të varet shumë nga fakti se kush do ta udhëheqë qeverinë e ardhshme.

Civilët ukrainas rrëfejnë tmerrin e përjetuar nga bombardimet ruse: Është si një video lojë për ta, na gjuajnë për sport



Banorët e Kherson-t në Ukrainë rrëfejnë tmerrin që përjetojnë nga sulmet e Moskës, thënë se janë ‘të shënjestruar nga dronët rusë’. 53-vjeçarja, Kateryna Drobinina e cila ka mbetur e plagosur nga një sulm rus thotë për “The Times” se “ne jemi gjuajtur qëllimisht”.

Drobinina së bashku me bashkëshortin ndesheshin në shtëpinë e fqinje, pasi sapo ishte bombarduar nga një dron rus. Sapo dëgjuan zhurmën e një droni tjetër, ata nxituan të strehoheshin nën një çati të ulët dhe u përqaftuan me njëri-tjetrin ndërsa zhurma e dronit bëhej më e fortë.

“Ne mund ta shihnim atë nga afër dhe droni mund të na shihte ne po ashtu. Një granatë u hodh përballë nesh. Të dy u plagosëm. Na gjuajtën sikur të ishte sport”, shton 53-vjeçarja nga shtrati i spitalit. Në fillim, sulmet me dronë u përqendruan në komunitetet buzë lumit në buzë të qytetit. Kherson, qyteti që dikur festonte fitimin e lirisë së tij nga pushtimi rus është bërë një provë e luftës moderne, në të cilën dronët janë

gurthemeli i një fushate terroriste.

Për disa ukrainas në Kherson, udhëtimi për në punë dhe krihimi është momenti më i frikshëm i ditës.

Iryna Lyba, një punonjëse 30-vjeçare nga administrata lokale, po kthehej nga puna me autobus, kur u sulmua nga një dron kamikaz. Në autobus ndodheshin 15 persona, ndërsa ajo thekson se droni kamikaz po i ndiqte. Nga sulmi mbetën të lënduar 6 persona, mes tyre ishte dhe Lyba, e cila doli nga autobusi e përgjakur dhe e turllosur nga bombardimi.

Epoka e terrorit

I pushtuar për tetë muaj nga forcat ruse pas fillimit të pushtimit në shkallë të plotë, Kherson u bë emblematike e shpresave të Kievit për një fitore të kundërt, pasi u çlirua nga trupat ukrainase në nëntor 2022.

Megjithatë, më pas, artileria ruse vazhdoi të bombardonte

qytetin nga pozicionet në anën lindore të lumit dhe më pak se 80,000 nga popullsia e Khersonit prej 300,000 banorësh të paraluftës janë kthyer.

Vjeshtën e kaluar zjarri i artilerisë filloi të pakësohej. Në vend të tij, valët e dronëve sulmues rusë filluan të kërcënojnë çdo ditë rrugët e Khersonit, duke fluturuar nga bregu lindor i Dnieper për të terrorizuar ukrainasit që mbetën në anën perëndimore.

Shumica e sulmeve përfshijnë drone DJI Mavic, të përdorura për të hedhur granata “limon” F1 ose bomba V-25 Vlog mbi këmbësorët dhe makinat. Ndonjëherë dronët hedhin grupe minash fluturash PFM-1 nëpër qytet, duke çuar në një rritje të amputimeve të fundit të këmbëve, shkruan “The Times”.

“Trajtoni çdo dron si armik”

Autoritetet lokale të Kherson-it kanë mbledhur lista të detajuara të statistikave për të përshkruar mbretërimin e terrorit të dronëve.

Në të gjithë rajonin më të gjerë të Khersonit, midis gushtit dhe dhjetorit të vitit të kaluar, autoritetet rajonale regjistruan 12,000 dronë rusë që kalonin përtej lumit Dnieper për të synuar ukrainasit, duke rezultuar në 64 civilë të vdekur dhe 609 të plagosur.

“Qëllimi i fushatës së dronëve është terrori i pastër. Rusët synojnë të shpopullojnë bregun perëndimor të Dnieper. Kthimi në Kherson mbetet një synim rus”, shpjegon kreu i administratës ushtarake rajonale të Khersonit, Oleksandr Prokudin.

Autoritetet lokale i janë përgjigjur shpejt kërcënimit të dronëve, duke i kushtuar një të tretën e buxhetit rajonal të Kherson 2024 në masa mbrojtëse, të cilat përfshijnë sisteme bllokimi, alarme paralajmëruese të hershme dhe fushata të informacionit publik.

Frika është ‘e prekshme’.

“Kur eci në rrugë dhe dëgjoj zhurmën e një droni, nuk mund të marr frymë siç

duhet”, thotë Natalya Savchenko, 68 vjeç, djali i së cilës, Vadim ishte plagosur nga një dron në kopshtin e tij. “Unë e di se çfarë të bëj: vrapoj në një strehë. Por që kur pashë djalin tim të plagosur dhe të gjakosur... më duket se tingulli është aq i frikshëm saqë luftoj për ajër”, shton ajo.

“Është një lojë video për ta”

Disa muaj më parë, përpara se modeli i goditjeve të fillonte të mbyllej në qendër, viktimat me dron zakonisht silleshin nga rrethet e largëta në spitalin Luchansky, një nga katër objektet kryesore mjekësore në qytet. Këto ditë të plagosurit kanë po aq gjasa të jenë këmbësorë të hedhur në erë nga dronët në rrugë jashtë. Disa ditë dronët rusë bombardojnë vetë spitalin.

“Atyre nuk u intereson se kë shënjestrojnë. Kam trajtuar qindra dronë të plagosur në muajt e fundit, të gjithë civilë,” thotë shefi i kirurgjisë së spitalit, Vitaliy Khomukha.

Giorgia, Zonja e hekurt

Shtypi ndërkombëtar është i detyruar ta pranojë këtë realitet. Politico e shpalli Melonin “figura më e fuqishme në Europë”. The Economist e vendosi në kopertinë mes Marine Le Pen dhe von der Leyen. Le Figaro e quajti “gruaja e re e fortë e Europës”, ndërsa The Times shkoi edhe më tej: “Mbretëresha e Europës”



Koka lart, shpina drejt, duart në ije. Qershorin e kaluar, gjatë samitit të G7 në Borgo Egnazia, Giorgia Meloni vallëzonte plot vetëbesim në ritmin e pizzica-salentine. Fustani i gjatë i bardhë i rrinte për mrekulli. Përreth saj nuk kishte liderë të pushtetshëm, por valltarë dhe popull. Ajo skenë u bë metafora e momentit të saj të artë. Giorgia vallëzoi e vetme, si në filmin poetik të Bertoluccit. Edhe pse politika, siç thoshte ish-ministri Rino Formica, është kryesisht “gjak dhe m*t”. E quajnë një lidere me tendencë të forta për përqendrim pushteti. Pak rëndësi ka. Ajo drejton një parti e cila, nga skajet e skenës politike, u bë qendrore. Është gruaja e parë kryeministre në Itali dhe, për më tepër, e djathtë. Një opozitë e çorganizuar, kundërshtarë agresivë, ministra problematikë, kolegë të papërvujtë. Vallëzoi e vetme, sigurisht. Mjafton të shohim disa nga lëvizjet e saj të fundit. Në Evropë, veprimi sipas kokës së vet, duke refuzuar t'i japë votën e besimit presidentes së re të Komisionit, Ursula von der Leyen. Ka forcuar miqësinë me Elon Musk, njeriun më të pasur dhe me ndikim në botë. Ka fituar mbështetjen e Donald Trump, i cili e lëvdon pa pushim. Pikërisht me një udhëtim të bujshëm në Florida, ku takoi ish-presidentin

amerikan, ajo arriti të zgjidhte një krizë të vështirë diplomatike: lirin e gazetares italiane Cecilia Sala, e arrestuar në Iran. “Giorgia i dëgjon të gjithë, por vendos vetë”, përmbledh një nga këshilltarët e saj më të besuar. Dhe metoda funksionon, falë edhe kontekstit të favorshëm. Epoka e saj, pavarësisht çfarë mendon ndokush, sapo ka nisur. “Qeveria ime është e shtata më jetëgjatë ndër 68 qeveritë e historisë italiane”, tha ajo në konferencën për shtyp në fillim të vitit. Nëse e çon mandatin deri në fund, do të bëhet më jetëgjata në histori. Aq sa edhe opozita, e cila deri dje ëndërronte një rrëzim të qeverisë, tani mendon për zgjedhjet e ardhshme. “Kush do ta sfidojë Melonin në 2027?” pyesin të pashpresë në Partinë Demokratike. Kryetarja e saj, Elly Schlein, duket më shumë si figurë dytësore. Dhe si do të formohet një koalicion opozitar?

Strategjia ndërkombëtare dhe lëvizjet gjeopolitike

Në mes të mandatit të saj, Meloni ka bërë lëvizjet më të suksesshme në arenën ndërkombëtare. Ajo është mbështetëse e zjarrtë e NATO-s dhe Ukrainës, një linjë e ndjekur që nga fillimi. Ndërkohë, rikthimi i Trump-it

në skenë po vë në rrezik Europën me kërcënimin për tarifa të reja doganore. Në këtë panoramë, Meloni është liderja europiane më e afërt me administratën amerikane – falë edhe marrëdhënies me Musk. Biznesmeni, i apasionuar pas historisë së lashtë, shkruan në X: “Amerika është Roma e re”. Përveç parimeve, ka edhe çështje konkrete. Pallati Chigi (selia e qeverisë italiane) është i interesuar për Starlink, rrjetin satelitor të internetit të krijuar nga Musk. Ky sistem do të sigurojë lidhje të mbrojtura, në një marrëveshje që mund të arrijë 1.5 miliardë euro për pesë vjet. Po ashtu, një tjetër projekt i madh synon integrimin e internetit me brez të gjerë, me 3.8 miliardë euro të alokuara nga fondet e PNRR. Eksperimenti do të nisë në Lombardi.

Meloni dhe Europa: një raport kompleks

Megjithëse nuk votoi për von der Leyen, raportet mes tyre janë korrekte dhe produktive. Presidentja e Komisionit Evropian u rizgjodh me një shumicë shumë të brishtë, pas negociatave mes konservatorëve dhe Partisë Popullore Evropiane. Meloni, e cila dikur u konsiderua si një “rrezik për Italinë dhe Europën”, sot është një nga figurat më të fuqishme të

kontinentit. Në fakt, politika evropiane është në krizë: Gjermania është në recesion dhe kancelari Scholz ka humbur mbështetjen. Franca e Macron po përjeton një kaos politik dhe ekonomik. Ndërsa Italia, paradoksisht, ka një nga qeveritë më të qëndrueshme të dekadave të fundit.

Shtypi ndërkombëtar është i detyruar ta pranojë këtë realitet. Politico e shpalli Melonin “figura më e fuqishme në Europë”. The Economist e vendosi në kopertinë mes Marine Le Pen dhe von der Leyen. Le Figaro e quajti “gruaja e re e fortë e Europës”, ndërsa The Times shkoi edhe më tej: “Mbretëresha e Europës”. Por vlerësimi më befasues erdhi nga The Guardian, një gazetë historikisht e majtë britanike. Ata e përshkruan si “pragmatiste dhe e aftë”, duke vënë në dukje se “në dy vjet ka befasuar shumë njerëz”. Ndërsa The Spectator e krahasoi me Margaret Thatcher, duke e quajtur një version “mesdhetar” të saj.

Problemet e brendshme dhe sfidat e ardhshme

Sigurisht, jo gjithçka është perfekte në Itali. Borxhi po rritet, prodhimi po bie, PBB-ja po pëson rënie. Por ka vende që po ecin edhe më keq:

Gjermania është në recesion, Franca nuk e kontrollon dot deficitin. Ministri i Ekonomisë, Giancarlo Giorgetti, ka miratuar një buxhet të kujdesshëm, duke mbyllur gropën e krijuar nga superbonoja fiskale e qeverisë së mëparshme të Contes. Nuk është shumë, por as pak. 2025-a, sipas Melonit, do të jetë viti i reformave të mëdha, përfshirë reformën e sistemit të qeverisjes dhe autonominë rajonale, dy çështje që kanë shkaktuar tensione mes aleatëve të saj politikë. Lega e Matteo Salvinit është e detyruar të mbajë flamurin e autonomisë, pavarësisht kundërshtimeve brenda koalicionit. Forza Italia, ndërkohë, po kërkon të realizojë reformën e drejtësisë, një ëndërr e vjetër e Berlusconi. Opozita vazhdon të jetë e përçarë dhe e çoroditur. Partia Demokratike është në krizë, Lëvizja 5 Yjet po shkon drejt shpërbërjes, Matteo Renzi është shndërruar në thjesht moralizues. Më shumë se sa Salvini apo Tajani, armiku më i dobishëm për Melonin mbetet Elly Schlein. Në këtë klimë, Zonja e Hekurt e Italisë vazhdon të kërcejë e vetme – në arenën kombëtare dhe ndërkombëtare. Dhe ndoshta, mes gjithë kritikave, ajo ndonjëherë shijon pizzica-n e saj të preferuar. / Me shkurtime nga Panorama Italia – Bota.al



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Arsenali deklason Manchester Cityn

LONDËR, 2 SHKURT - Arsenali ka shënuar fitore të thellë me rezultat 5-1 ndaj Manchester Cityt në kuadër të javës së 24-të në elitën e futbollit anglez. Vendasit kaluan në epërsi në minutën e dytë pas një gabimi të Manuel Akanjit, i cili i dhuroi mundësinë Martin Odegaard të shënonte për rezultatin 1-0. “Topçinjtë” menduan se kishin realizuar edhe golin e dytë në këtë takim kur Gabriel Martinelli e çoi

topin në fundin e rrjetës në minutën e gjashtë, por ai u anulua për pozitë jashtë loje. Në anën tjetër rasti i parë për “Qytetarët” në këtë pjesë erdhi në minutën e 24-të kur gjuajtjen me kokë të Josko Gvardiol e priti në mënyrë fantastike David Raya. Një tjetër rast të mirë shënimi e pati edhe braziliani Savinho në minutën e 43-të, por sërish në skenë doli Raya për t’ia mohuar golin e barazimit.

Përfundon pjesa e parë: Arsenali me epërsi të merituar ndaj Manchester Cityt Me të filluar pjesa e dytë, Manchester City realizoi golin e barazimit përmes Erling Haaland (55’) i cili shënoi me kokë për 1-1 pas asistimit të Savinhos. Sidoqoftë, gëzimi i Cityt nuk zgjati as një minuta, pasi menjëherë në aksionin vijues, Arsenali ia doli të rikthejë epërsinë duke shënuar përmes Thomas

Partey (56’) për 2-1. Të besuarit e Mikel Artetas nuk u ndalën më kaq dhe realizuan sërish, kësaj radhe përmes të riut Leëis-Skelly (62’) që shënoi një gol të bukur për 3-1. Listës së golashënuesve iu bashkua edhe Kai Havertz i cili në minutën e 76-të realizoi për 4-1 pas asistimit të Gabriel Martinellit, teksa për rezultatin përfundimtar u përkujdes Ethan Nwaneri i cili realizoi për 5-1 në minutën e



93-të. Me këtë fitore Arsenali shkon në kuotën e 50 pikëve të grumbulluara dhe mban pozitën e dytë në renditje, teksa City me 41 sosh renditet e katërta.

Derbi i takon Trepçës, Kryeqytetasit triumfojnë në Prizren

“Epoka e re”

MITROVICË, 2 SHKURT - Trepça ka triumfuar në derbin e javës së 20-të të ProCredit Superligës, duke fituar ndaj Pejës me rezultat 67:66 (18:15, 21:11, 18:21, 10:19). Çereku i parë ishte i baraspeshuar, por vendasit me gjashtë pikë radhazi, e përfunduan këtë pjesë në të mirë të tyre 18:15. Mitrovicasit vazhduan me lojë të mirë në periudhën e dytë, për të thelluar epërsinë dhe për të

shkuar në pushim me shifrat 39:26. Ndeshje shumë interesante u zhvillua në pjesën e dytë, ku Peja në fund arriti të barazojë shifrat në 66:66, me anë të Amin Hot, derisa pikën e fitores e shënoi Tekele Cotton për 67:66 dhe triumfin e Trepçës në derbi. Mikaile Tmusiq kishte 17 pikë e katër kërcime për vendasit, derisa Amin Hot 14 pikë, tetë kërcime e shtatë asistime për mysafirët. Trepça ka 14 fitore e gjashtë humbje, derisa Peja dhjetë fitore e dhjetë humbje. Ndërsa Sigal Prishtina fitoi ndaj

Bashkimit në Prizren me rezultat 71:77 (25:18, 13:29, 12:16, 21:14). Të përkrahur nga tifozët vendas, prizrenasit e nisën sfidën më mirë, duke fituar çerekun e parë, 25:18. Por, bardhekaltrit u rikthyen shpejt, duke bërë përmbysjen dhe shkuan në pushim me nëntë pikë epërsi 38:47. Bardhekaltrit për një nuancë ishin më të mirë edhe në periudhën e tretë, 12:16, derisa vendasit u munduan të rikthehen në dhjetë minutat e fundit, por nuk ia arritën qëllimit dhe kryeqytetasit



fituan 71:77. Më i miri te vendasit ishte Wendell Green me 17 pikë, katër kërcime e gjashtë asistime, ndërsa te mysafirët më i miri ishte Rashid

Mahalbashiq me 11 pikë e 13 kërcime. Bashkimi ka 14 fitore e gjashtë humbje, ndërsa Sigal Prishtina ka 12 fitore e tetë humbje.

Rahoveci fiton kryendeshjen në Pejë, barazim mes Llapit e Prishtinës

PEJË, 2 SHKURT - Të shtunën janë luajtur dy ndeshjet e para të stinorit pranveror në Superligën e Kosovës në hendboll në konkurrencë të meshkujve. Në kuadër të xhiros së 15-të, në palestrën “Karagaçi” në Pejë u zhvillua kryendeshja mes Besa Famgasit dhe Rahovecit. Me rezultat 37:30, fitore shënoi Rahoveci. Për Rahovecin është fitorja e 15-të rresht dhe tani udhëheqë në tabelë me 30 pikë. Besa mbetet e dyta me 22 pikë. “Vreshtarët” thuajse nga fillimi i ndeshjes mbajtën epërsi prej disa golash. Në fund dallimi ishte shtatë

gola. Egzon Gjuka i realizoi 11 gola për Rahovecin. Shtatë i kishte Antonio Vozila, kurse pesë i realizoi Jeton Bislimi. Olsi Mulaj i kishte tetë gola për Besën. Balsha Çejoviq i shënoi gjashtë, ndërsa pesë i kishte Amar Muqolli. Ndërkohë Trepça i ka fituar pikët e para këtë edicion. Në “Minatori” e mposhti Vushtrinë me rezultat 31:26. Sali Maxhera ishte më efikas te mitrovicasit me tetë gola. Shtatë i kishte Luigj Kolaj, ndërsa nga pesë i shënuan Ermir Smaka e Ardi Halili. 14 gola për vushtrriasit i shënoi Erkan



Abazzhiku. Pesë i kishte Egzon Ademi. Trepça i ka dy pikë në pozitën e fundit. Vushtria është e pesta me tetë pikë. Nuk ka dhënë fitues ndeshja mes Llapit dhe Prishtinës, e zhvilluar të dielën në Podujevë. Ndeshja e xhiros së 15-të, përkatësisht e xhiros të parë të stinorit

pranveror në Superligën e Kosovës në hendboll, përfundoi 34:34. Ndeshja nisi më mirë për prishtinasit. Prishtina kishte epërsi prej disa golash, ndërsa vendasit barazuan në 10:10 në minutën e 17-të. Në minutën e 19-të u regjistrua epërsia e parë e llapanëve, 12:11, e më pas edhe 13:11. Pjesa e parë përfundoi 19:17 për Llapin. Epërsi prej dy e tri golash, Llapi kishte deri në minutën e 54-t, kur rezultati u barazua në 31:31. Sërish vendasit u shkëputën në 33:31 me golat e Enis Rexhepit e Fatlum Hasanit. Altin Cacaj e

Albi Gjuka shënuan për 33:33. Në minutën e 58-të, Artir Berisha i vendasve shënoi për 34:33, ndërsa në minutën e 59-të, Oltion Beshiri shënoi për 34:34. Blerton Hasani i kishte tetë gola për Llapin, Fatlum Hasani shtatë e Artir Berisha pesë, sa edhe Etnik Bajoku. Oltion Beshiri i shënoi 10 gola për Prishtinën. Gjashtë i shtoi Albi Gjuka, ndërsa nga katër i realizuan Mërgim Ademi, Altin Cacaj e Ylli Visoka. Për Prishtinën ishte pika e 17-të. Mban vendin e katërt në tabelën e Superligës. Llapi është i pesti me nëntë pikë.

Danimarka, kampione e botës për herë të katërt rresht

Oslo, 2 shkurt - Danimarka e ka vazhduar dominimin e plotë në Kampionatin Botëror të hendbollit, duke mposhtur Kroacinë në finale. Danezët e jashtëzakonshëm të dielën mbrëmë e siguruan titullin e katërt rresht të botës, duke triumfuar në

finale të Kampionatit Botëror 2025, me rezultat 32:26. Finalja u zhvillua në Unity Arena (Oslo) të Norvegjisë në atmosferë të shkëlqyer. Lojtarët e Danimarkës kanë dominuar nga fillimi e deri në fund. Në portë i hatashëm ishte Emil Nielsen, ndërsa mbrojtja

po ashtu ishte shumë e lëvizshme dhe shumë e fortë. Ndërkohë edhe sulmi i danezëve ka funksionuar gati në mënyrë të përkryer. Kroatët sërish u shfaqën luftarakë, por që nuk mjaftojë në finale. Për Kroacinë është sukses i madh edhe arritja në

finale të Kampionatit Botëror. Danimarka është pa humbje në Kampionat Botëror që nga viti 2017. Botërorin e parë e fitoi në vitin 2019. Kampione ishte edhe në vitet 2021 e 2023. Te Danimarka pos Nielsenit ndeshje të madhe kishte edhe Mathias Gidsel që realizoi



10 gola nga 11 tentime. Medaljen e bronzitë e fitoi Franca, që fitoi 35:34 ndaj Portugalisë.



KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE

"Ambienti" SH.A PEJË
NR 192DATA 31.01.25

Kompania Regjionale e Mbeturinave "Ambienti" Sh.A. Pejë
Me adresë Rr.Xhem Sadrija pn ,Fusha e Pejës-Tranzit KK Pejë

Bazuar ne ligjin e Punës: LIGJI Nr. 03/L-212 sipas neni 8,dhe në bazë të Udhzimit Administrativ MFPT- NR 01/2024,
Kryeshefi Egzekutiv i Kompanis Regjionale të Mbeturinave "Ambienti" Sh.A. Pejë me datë 03.02.2025, shpall konkurs të
brendshëm për këto vende të punës :

KONKURS I BRENDSHËM

Pozita : Kryepunëtor i terrenit - 1 pozitë

Vendi punës : Pejë

Kohëzgjatja e periudhës provuese është 6 muaj me mundësi vazhdimi sipas kontratave të ligjit të punës.

Koeficienti i pagës : 2.3

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

1. Organizon dhe koordinon punën e punëtorëve në ndrrime, cakton punëtorët dhe automjetet në kryerjen e punës së përditëshme operative në itinerarin e caktuar;
2. Mban evidencë për çdo punëtor për itinerarin e tij dhe kryen llogarinë e efektit të punës për çdo punëtor;
3. Përpilon planin ditor dhe mujor të punës në bazë të planit operativ;
4. Përcjell dhe kontrollon shfrytëzimin e kohës së punës për çdo punëtor, i evidenton dhe raportin e dorëzon në administratë dhe operativë, si dhe ditarin e punëve të kryera ia dorëzon menaxherit operativ;
5. Kontrollon realizimin e detyrave ditore të punëtorëve në terren;
6. Të gjitha problemet në terren është i obliguar t'i parashtojë me kohë te udhëheqësi i sektorit;
7. Drejtëpërdrejt kontrollon kualitetin e punës në terren dhe ua tërhek vrejten punëtorëve që gjatë kryerjes së punëve të mos i dëmtojnë automjetet;
8. Është përgjegjës për rregullsinë teknike dhe pastërtinë e automjetit;
9. Kërkon nga vozitësit e automjeteve që në terren të sillen korrekt dhe të ndalen për grumbullimin e hedhurinave në vende të përshtatshme ku nuk pengohet komunikacioni dhe lëvizja e qytetarëve.
10. Është përgjegjës për përdorimin e mjeteve mbrojtëse në punë.
11. Kryen edhe punë tjera me urdhëres të Menaxherit të Operativës, Kordinatorit Operativ;
12. Për mos respektimin e pikave te lartecekura i përgjigjet drjtëpërdrejt, Kryeshefit Ekzkativ.

a. Kushtet e përgjithshme :

- CV;
- Çertifikatë që kandidati nuk është nën hetime;
- Letër motivimi;
- Kopja e letërnjoftimit;
- Çertifikatë mbi gjendjen shëndetësore.

b. Kushtet e veçanta :(kualifikimet profesionale)

- Shkolla e mesme;
- 1vite përvojë pune e dëshmuar;
- Ai /Ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën presion, të ketë moral të fortë për punë dhe integritet të nivelit të lartë.

Mënyra e Aplikimit:Dokumentacioni duhet të dërgohen ne e-mailit krmambientikonkurset@gmail.com

Data e për aplikim është nga 03.02.2025 deri me 18.02.2025 ora 12:00. Dokumentacioni që mbërrin pas afatit dhe i pakompletuar do të konsiderohet i pavlefshëm.. Dokumentet origjinale mund të kërkojnë, sipas nevojës. Vetëm kandidatët e selektuar për listën e ngushtë do të kontaktohen.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë





www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT



SWISS

TAVERNA



Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË



Lume's Details

Estetik & Depilim



 044 900 978 | 045 681 898

 Sallon Depilimi Lume's Details

 lumesdetails

 Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE

"Ambienti" SH.A PEJË

NR 192

DATA 31.01.25

Kompania Regjionale e Mbeturinave "Ambienti" Sh.A. Pejë
Me adresë Rr.Xhem Sadrija pn ,Fusha e Pejës-Tranzit KK Pejë

Bazuar ne ligjin e Punës: LIGJI Nr. 03/L-212 sipas nenit 8,dhe në bazë të Udhzimit Administrativ MFPT- NR 01/2024, Kryeshefi Egzekutiv i Kompanis Regjionale të Mbeturinave "Ambienti"Sh.A. Pejë me datë 03.02.2025, shpall konkurs të brendshëm për këto vende të punës :

KONKURS I BRENDSHËM

Pozita : Kryepunëtor i terrenit - 1 pozitë

Vendi punës : Pejë
Kohëzgjatja e periudhës provuese është 6 muaj me mundësi vazhdimi sipas kontratave të ligjit të punës.
Koeficienti i pagës : 2.3

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësiave të punës:

1. Organizon dhe koordinon punën e punëtorëve në ndrrime, cakton punëtorët dhe automjetet në kryerjen e punës së përditëshme operative në itinerarin e caktuar;
2. Mban evidencë për çdo punëtor për itinerarin e tij dhe kryen llogarinë e efektit të punës për çdo punëtor;
3. Përcjell planin ditor dhe muajor të punës në bazë të planit operativ;
4. Përcjell dhe kontrollon shfrytëzimin e kohës së punës për çdo punëtor, i evidenton dhe raportin e dorëzon në administratë dhe operativë, si dhe ditarin e punëve të kryera ia dorëzon menaxherit operativ;
5. Kontrollon realizimin e detyrave ditore të punëtorëve në terren;
6. Të gjitha problemet në terren është i obliguar t'i parashtrijë me kohë të udhëheqësi i sektorit;
7. Drejtëpërdrejt kontrollon kualitetin e punës në terren dhe ua tërheq vrejtyen punëtorëve që gjatë kryerjes së punëve të mos i dëmtojnë automjetet;
8. Është përgjegjës për rregullsinë teknike dhe pastërtinë e automjetit;
9. Kërkon nga vozitësit e automjeteve që në terren të sillen korrekt dhe të ndalen për grumbullimin e hedhurinave në vende të përshtatshme ku nuk pengohet komunikacioni dhe lëvizja e qytetarëve.
10. Është përgjegjës për përdorimin e mjeteve mbrojtëse në punë.
11. Kryen edhe punë tjera me urdhëres të Menaxherit të Operativës, Kordinatorit Operativ;
12. Për mos respektimin e pikave te lartecelkura i përgjigjet drjtëpërdrejt, Kryeshefit Elzkuktiv.

a. Kushtet e përgjithshme :

- CV;
- Certifikatë që kandidati nuk është nën hetime;
- Letër motivimi;
- Kopja e letërnjoftimit;
- Certifikatë mb i gjendjen shëndetësore.

b. Kushtet e veçanta :(kualifikimet profesionale)

- Shkolla e mesme;
- 1 vite përvojë pune e dëshmuar;
- Ai /Ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën presion, të ketë moral të fortë për punë dhe integritet të nivelit të lartë.

Mënyra e Aplikimit:Dokumentacioni duhet të dërgohen ne e-mailit krmambientikonkurset@gmail.com
Data e për aplikim është nga 03.02.2025 deri me 18.02.2025 ora 12:00. Dokumentacioni që mbërrin pas afatit dhe i pakompletuar do të konsiderohet i pavlefshëm.. Dokumentet origjinale mund të kërkohej, sipas nevojës. Vetëm kandidatët e selektuar për listën e ngushtë do të kontaktohen.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Berat Terpuni nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme "Nexhmedin Nixha".

- Elvis Kuzhnini B.I. NGA Gjakova shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 810107161.

- Kristjan Margegaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës së mesme Teknike "Nexhmedin Nixha".

- Mimoza Ahmeti nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme të mjekësisë "Hysni Zajmi".

- Ilmi Sadrija nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës fillore "Pjetër Bogdani".

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshohet banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një

dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992







ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

